



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 770 Prot.

Shkodër, më 21.02 2025

V E N D I M

Nr. 52, datë 21.02 2025

"PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 33; Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", neni 86 dhe 87; sugjerimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 7511/I prot, datë 03.02.2025, protokolluar në Rektorat me nr. 499 prot, datë 05.02.2025, në kuadër të domosdoshmërisë për plotësimin e procedurës për kryerjen e ndryshimeve në Statut, procedurë kjo e iniciuar me Vendimin e BA nr. 270, datë 26.11.2024 "Për miratimin e organigramës si pjesë integrale e Statutit të USH-së" dhe Vendimi i Senatit Akademik nr. 272, datë 27.11.2024 "Për miratimin e ndryshimit të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", me shtimin e organigramës si shtojcë të tij", Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 21.02.2025;

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si më poshtë vijon:

- Në nenin 8 të Statutit të USH-së, të shtohet pika 3, me këtë përmbajtje: *Organigrama e USH-së, përcaktohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.*

- Në pikën 5, të nenit 9, të Statutit të USH-së, emërtimi: (Fakulteti i Shkencave Natyrore), korrigjohet dhe unifikohet në: *(Fakulteti i Shkencave të Natyrës).*

- Pika 6, e nenit 9, i Statutit të USH-së, të riformulohet si vijon: *Përbërja e fakulteteve përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur statutit dhe në rregulloret e tyre.*

2. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Bonif Gjuraj

